Lënda: **Ftesë për pjesëmarrje në debat**

Të nderuar ,

Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (QMBN) me kënaqësi Ju fton që të merrni pjesë në debatin në temën **"Gjendja aktuale dhe sfidat e diskriminimit në bazë të përkatësisë etnike".**

Debati do të mbahet më **5 dhjetor 2013 (e enjte)** në **ora 11:00** në **h. Holiday Inn** në Shkup.

Në debat do të diskutohet situata aktuale në Maqedoni, përvojat dhe praktikat evropiane mbi trajtimin e diskriminimit në baza etnike. Folës do të jenë Agim Nuhiu, profesor universitar dhe anëtar i KMD dhe Lulzim Haziri, drejtor programi në ADI. Debatin do ta moderojë Ilina Mangova nga IDSCS .

Pjesëmarrësit do të mundësi që të kyçen në mënyrë aktive në diskutime, duke sjellë idetë dhe komentet e tyre që do të evidentohen në mënyrë të rregullt dhe drejtë të cilave do të orientohen zgjidhjet në të ardhmen .

Debati është pjesë e projektit "Nga norma në praktikë - për barazi" i cili implementohet nga ana e QMBN në partneritet me Polio Plus-lëvizje kundër handikapit, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Projekti mbështetet financiarisht nga programi Progress (2007-2013) i Bashkimit Evropian.

Qëllimi kryesor i projektit është të kontribuojë në respektimin e barazisë dhe për të fuqizuar luftën kundër diskriminimit, duke rritur ndërgjegjësimin e publikut të gjerë, por edhe akterëve kyç në shoqëri. Për më tepër, projekti synon të përmirësojë instrumentet dhe mekanizmat ligjore kombëtare, në mënyrë që të tejkalohen sfidat më të mëdha në trajtimin e diskriminimit në praktikë.

Ju lutemi të emëroni përfaqësues nga institucioni/organizata tuaj për këtë event deri më **4 dhjetor, (e mërkurë)**, dhe të konfirmoni prezencën në e-mail fsh@mcms.mk.

Prania juaj do të begatojë ngjarjen.

Për gjitha informatat shtesë kontaktoni me Fisnik Shabani në tel. 070 632 692.

Shtojcë: Rendi i ditës

Me respekt,

Aleksandar Krzalovski
Drejtor i parë ekzekutiv

FSb/FSb

08-72/47-2013
Shkup, 28.11.2013

Dimçe Mitreski
Drejtor ekzekutiv

Projekti „**Nga norma në praktikë**“ është i mbështetur nga Programi i Bashkimit Evropian për punësim dhe solidaritet social – PROGRESS (2007-2013)

Debat: "Gjendja aktuale dhe sfidat e diskriminimit në bazë të përkatësisë etnike"

5 dhjetor 2013 г. (e enjte), ora 11:00.

Vendi : h. Holiday Inn

Rendi i ditës

11:00 – 11:15	**Regjistrimi i pjesëmarrësve**
11:15 – 11:30	**Hyrje në debat dhe prezantimi i projektit „Nga norma në praktikë“** Ilina Mangova, hulumtues nga IDSCS
11:30 – 12:00	**Tema: Legjislacioni vendor, politikat dhe praktikat e diskriminimit në baza etnike** Lulzim Haziri, Drejtor programi në ADI *Përmbajtja: Gjendja aktuale mbi diskriminimin në baza etnike në marrëdhëniet e punës, arsim, qasje deri te shërbimet me karakter publik. (Mos)njohja e konceptit (jo)diskriminim dhe masat për arritje të barazisë reale*
12:00 – 12:30	**Tema: Kornizat e funksionimit dhe roli i KMD në luftën kundër diskriminimit në baza etnike** Agim Nuhiu, profesor universitar dhe anëtar i KMD *Përmbajtja: Sfidat e diskriminimit në baza etnike;* *Roli i institucioneve të sistemit në luftën kundër diskriminimit në baza të përkatësisë etnike, në veçanti të Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi (KMD)*
12:30 – 13:00	**Diskutim**
13:00	**Koktel**

Projekti „**Nga norma në praktikë**“ është i mbështetur nga Programi i Bashkimit Evropian për punësim dhe solidaritet social – PROGRESS (2007-2013)